

Fadil Vokrri, legjenda e papërsëritur e futbollit shqiptar

Fadil Vokrri ka mbetur në imazhin e sportdashësit shqiptar si një legjendë e papërsëritshme sportive. Talenti i tij e ka ndërkombëtarizuar atë si futbollist dhe dinjiteti i tij njerëzor e ka bërë të dashur dhe të respektuar figurën e tij për të gjithë. Intervista me të, e cila u zhvillua në shtëpinë time në Dallas, ka mbetur në kujtesën time si një kënaqësi krejtësisht e veçantë.

nga Gjekë Marinaj

Pyetje: Ju jeni padyshim njëri prej emrave më të respektuar në futbollin shqiptar. Sa i rëndësishëm është respekti i publikut për një sportist?

F. Vokrri: Faleminderit për fjalët e mira. Historia e futbollit shqiptar nuk ka nisur as nuk do të përfundojë me Fadil Vokrrin. As respekti i publikut nuk fillon as nuk mbaron me një brez të vetëm sportistësh. Rrethanat e çastit janë shumë të vështira për të gjithë sportistët shqiptar. Mungesa e infrastrukturës së sportit, e terreneve të stërvitjes, si dhe mungesa e disa kushteve të tjera të domosdoshme e vështirësojnë pa masë nivelin e futbollit. Këto gjëra kanë të bëjnë direkt me formimin e sportistëve. Megjithatë koha po tregon se kombi ynë ka nxjerrë dhe po nxjerr nga gjiri i saj futbollistë mjaft të respektuar në arenën e futbollit shqiptar dhe botëror. Kjo vazhdimësi më gëzon pa masë.

Pyetje: Megjithëse rëndësia e talentit zë një vend të padiskutueshëm në jetën profesionale të sportistëve, a mund të themi që talenti nuk është gjithçka për të arritur një sukses të plotë profesional? Cilat janë disa nga komponentët e tjerë të domosdoshëm në krijimin e një futbollisti me potencial të plotë sportiv?

F. Vokrri: Sigurisht, talenti është baza kryesore. Megjithatë talenti duhet shoqëruar, ndër të tjera, edhe me një stërvitje të vazhdueshme, me një pasion të veçantë për sportin, me një sedër të lartë personale dhe kombëtare.

Pyetje: Vetë pozicioni politik që ka pasur Jugosllavia e atëherëshme ndaj Kosovës e ka bërë gati të pamundur afirmimin e shqiptarëve të Kosovës në nivelin ndërkombëtar. Këtu ka patur përjashtime të veçanta vetëm për talente të ralla si Fadil Vokrri. Si do e përshkruanit jetën tuaj sportive dhe shoqërore gjatë kohës që ishit futbollist pranë Klubit Sportiv "Partizani" në Beograd?

F. Vokrri: Sigurisht që ka qenë e vështirë të aktivizohesh me një klub të tillë. Sidoqoftë, nuk dua të jem shumë egoist, por vërtet ka qenë shumë e vështirë të çaje në atë vend. Unë kam



Fadil Vokrri, pasi e ka lënë futbollin

qenë i pari dhe i fundit shqiptar që kam luajtur me kombëtaren e ish Jugosllavisë. Është e vërtetë që për një shqiptar ka qenë gati e pamundur... Më së fundi, jam krenar që i përfaqësova të gjithë shqiptarët në mënyrë të denjë.

Pyetje: Ne jemi të familjarizuar, nga ndeshjet që kemi parë në televizion, me respektin që ka treguar publiku Beogradas ndaj jush në fushën sportive. Pavarësisht nga kjo, mendoj se do të ishte interesante ta dinim nga ju se si ju ka pritur sportdashësi Jugosllav jo vetëm në fushën e futbollit, por edhe jashtë saj?

Vokrri: Ka pasur pengesa si në çdo fillim, por interesat kanë qenë më të mëdha. Pas një kohe të shkurtër, nuk dua t'ju gënjej, unë kam kaluar një kohë fantastike në Beogradin e asaj kohe. Unë e di mirë se si politika i shtyn përçarjet, por nuk duhet t'i përgjithësojmë gjërat. Respekti i simpatizantëve ka qenë shumë i madh. Po kështu i kolegëve e sidomos i Klubit. Natyrisht, pëlqej të besoj, se ka qenë edhe loja ime ajo që e ka bërë të mundur këtë respekt.

Pyetje: Në vitin 1989, një nga stacionet e televizionit të Beogradit ju pati ftuar që të këshillonit minatorët e Trepçes për të hequr dorë nga greva e urisë, të cilën e kishin filluar disa ditë më parë. Ju nuk e pranuat këtë ftesë. A keni patur ndonjë problem mbas

mospranimit të asaj ftese?

F. Vokrri: Jo. Mua më ftuan të jap një apel që minatorët të dalin nga greva dhe, siç e thatë edhe ju, unë u thashë atyre që nuk isha dakord. U thashë që unë jam sportist dhe jo politikan dhe se çështjet politike dëshiroj t'ua lë atyre që politikën e njohin më mirë se unë. Dhe kaq.


Gj.M.: Jeta sportive, sidomos ajo e futbollit, është relativisht e shkurtër. Kështu, fundi i karrierës së futbollistëve arin para gjysmës së parë të jetës së tyre. Për t'u gjetur i gatshëm në përballimin e jetës mbas sportit, sa e rëndësishme është që sportistët të jenë të shkolluar dhe të brumosur me një farë niveli të përgjithshëm kulturor?

Vokrri: Kultura është pa dyshim nga më kryesoret. Unë mund të them se sidomos në këtë kohë është gati aq e rëndësishme sa ç'është edhe talenti. Sa do i talentuar të jesh, nëse nuk e njeh jetën sa e si duhet, nëse nuk je i shkoll-

uar sa e si duhet dhe sillsh pa maturinë e nevojshme, do të kesh një limit në ecurinë e suksesshme si sportist.

Pyetje: Sportdashësit shqiptarë të kanë dashur dhe respektuar edhe në kohët më të vështira. Sa ka ndikuar në rritjen e konfidencës suaj si sportist dhe njeri respekti i tyre?

Vokrri: Jam shumë i kënaqur me respektin që kam fituar tek njerëzit. Fadil Vokrri sot është një njeri i thjeshtë që nuk luan më futboll. Të gëzosh, ama, respektin e njerëzve edhe të kujtohesh me respekt prej tyre edhe pse ka kaluar shumë kohë, është ajo që më kënaq dhe më jep konfidencë jetësore në çdo moment të jetës time.




Vokrri së bashku me Bruno Cekën dhe Sulejman Demollarin në Teksas

Ndeshje miqësore (femrat) Shqiponjat-Kosova (P) 3:3

nga Vullnet Ademi

Në fushën e futbollit të skuadrës së "Dritës" nga Bogovina u zhvillua ndeshja miqësore kombëtare në mes të skuadrës Shqiponjat nga Hasanbegu dhe skuadrës Kosova nga Prishtina.

Të dyja skuadrat treguan një lojë tejet të mirë për sy, edhe përkaj faktit se futbollistët nuk kishin kushte për të dëshmuar kualitetet e tyre individuale dhe ishin përqëndruar në një lojë kolektive. Shqiponjat, të cilat kanë një përvojë më të madhe, që nga minuta e tretë e ndeshjes kaluan në avantazh, me golin që e shënoi Brahimi, pasi që nga gjysma e fushës së tyre e mori topin dhe e vendosi në portën e mysafireve nga Prishtina. Futbollistët e Kosovës në minutën e 22 të ndeshjes aritën përmes një goli tejet të bukur të Aliut nga 35 metra të barazojë në 1:1. Në minutën e



Pamje nga ndeshja e femrave

34 të ndeshjes rivënje nga këndi, Brahimi ekzekutoi përderisa Ismaili me kokë e mposhti portieren Shala për avantazh 2:1.

Me këtë rezultat u mbyll pjesa e parë e ndeshjes. Në pjesën e dytë të ndeshjes të reshurat e shiut edhe më shumë i vështirësuan kushtet për lojë, por futbollistët aritën që të tregojnë lojë të mirë. Në minutën e 50 të ndesh-

jes edhe një herë në qendër të vëmendjes ishte Aliu dhe barazoi rezultatin në 2:2 ishte ky barazimi i dytë. Në minutën e 66 të ndeshjes futbollistja më e mirë në Maqedoni për vitin 2002, Shyrete Braimi, sërish depërtoi në zonë krosi nga e majta përderisa Salihi e shfrytëzoi gabimin e portieres mysafire për 3:2.

Në minutën e 75 të

ndeshjes gaboi portieri Xheladini, ndërsa në vendin e duhur ishte Zejnullahu për të barazuar rezultatin për të tretën herë dhe për të vendosur rezultatin përfundimtar 3:3. Rezultati nuk ishte në rend të parë por ai ishte vendosur në rend të dytë, shoqërimi ishte i nivelit të lartë dhe loja e cilësisë së mirë në krahasim me kushtet të cilat mbretëruan në këtë teren dhe në një lojë të mirë të vashave nuk ariti që të inkuadrohet edhe kryesori i ndeshjes referi Ismaili, që shumë herë mori gabime vendimtare.

Tani ngel që të zhvillohet ndeshja e kthimit në të cilin Shqiponjat do duhet të jenë mysafire në Prishtinë, me qëllim të popullarizimit të futbollit të femrave, me të njëjtin rol që kishte edhe kjo ndeshje. Njeriu i dytë në shtëpinë tonë të futbollit Rexhep Bexheti ishte i pranishëm në këtë ndeshje miqësore kombëtare.

Fort Lee H.V.A.C., Inc.

Air Conditioning and Refrigeration

New York City: Tel: 347-245-0347

New Jersey: Tel: 201-363-9319

Serving Manhattan and

Northern New Jersey

Licensed by E.P.A. NYC F.D.

email: fortleehvac@yahoo.com

Central A/C

Roof - Top and Package Units.

Walk-in Coolers and Freezers.

Split and Mini - Split Systems

Heat Pumps and Gas Fired Furnaces.

Corporate Accounts Wellcome

Monthly and Seasonal Contracts Available

Commercial, Residential and Industrial

PIAZZA

Restaurant Piano Bar Cafe

Galeria XXI - Piazza

Bardha Books

Rruga Dedë Gjo' Luli, Tiranë

Tel. 011355 42 30 706